

## **Perceptimi i pergjegjesise se perbashket**

Shkolla dhe ju jane te interesuar qe femija i juaj rregullishte dhe me sukses ta viziton shkollen. Nje bashkepunim i mire ne mes jush dhe shkolles ne cilen shkon femija i juaj eshte themeli me mire.

### **Te dashur prinder,**

Inicijatorët e projektit iu falenderohen shkollave të zgjedhura që të marrin pjesë në këtë projekt dhe me ju të lidhen marrëveshjet e duhura për aplikimin e ketyre masave që do të rregullojnë prezencën e femijes suaj gjatë orëve të mesimit.

Kontakti: Vula e shkolles:

Keshilli preventiv i Republikës  
Niedersachsen  
- Ministrija juridike Niedersachsen -  
Am Waterlooplatz 5A  
30169 Hannover

Telefoni 0511 / 120-5254  
Telefaksi 0511 / 120-5272  
Email [info@lpr.niedersachsen.de](mailto:info@lpr.niedersachsen.de)  
Internet [www.lpr.niedersachsen.de](http://www.lpr.niedersachsen.de)

## **Projekt per tiu shmangur mungesave te paarsyeshme nga mesimi**

 Niedersachsen



Ministrija për Kulturë në Niedersachsen  
Ministrija për çështje Sociale, Gruan, Familjen  
dhe Shëndetësi në Niedersachsen  
Ministrija e Puneve të Mbrodshme në  
Niedersachsen  
Ministrija Juridike në Niedersachsen

Keshilli preventiv i Republikës Niedersachsen

## **Te dashur prinder,**

ne po iu drejtohem juve me kete broshur sepse deshirojme qe me forcat e perbashketa te kujdesemi qe nxeneset dhe nxenesit te marrin pjese rregullisht ne mesim.

Hulumtimet tregojne se ikja mesimi (ose mungesat paarsy) ne pergjithsi eshte shtuar, dhe se me vone kjo dukuri munde te shpiej drejt asaj, qe shkolla te refuzohet plotesisht..Sipas nje anketes me nxeneset dhe nxenesit e klases se 9., gjysma ka pohuar se ne gjysmevjetorin e fundit kane ikur nga mesimi per nje e me shume dite. Pothuaj 15% ne kete periudhe, kane ikur me shume se 5 dite nga mesimi. Nxenesit qe ikin mesimit nuk jane te lindur si te tille. Ky eshte nje proces i gjate deri sa nje nxenese apo nxenes ne menyre sistematike mungon. Ne deshirojme qe se bashku ti kundervihemi kesaj dukurie. Ikja nga mesimi e veshtirson perfundimin e shkolles dhe me kete edhe qasjen ne jeten e profesionit.

Per kete arsye, Qeveria e Niedersachsens e ka zhvilluar kete projekt me temen "Per nje shkolle me te mire" kunder ikjes nga mesimi dhe refuzimit te shkolles.Ne kuader te kesaj idese do te ushtrohet nje veprimtari e perbashket ne mes te shkolles dhe prinderve qe dalja ne mesim te jete e

rregullt. Rezultatet e ketij akcioni do te vleresohen prej vitit 2005.

Projekti do te aplikohet ne me se 60 shkolla, ne qytetet dhe rrethet e gjedhura, me pjesemarrjen e arsimtarve dhe Enteve per te Rinj.

Caktimi i shkollave ku do te aplikohet ky projekt do te behet sipas nje procedure shkencore permes teorise se gjasave(rastesisht). Percjellja shkencore do te behet nga Universiteti i Hamburgut. Projekti perfundon ne pranveren e vitit 2004.

Ne ju lutemi perzemersishte per perkrahjen tuaj.

Cfare do te thote kjo per ju si prinder dhe per shkollen e femijes suaj?

## **Shkolla dhe prinderit lidhin nje marreveshje**

Femija i juaj duhet ta dije, qe nese mungon paarsy, menjher do te vendoset kontakti ne mes shkolles dhe prinderve. Per kete kontakt duhet te lidhet nje marreveshje. Shkolla obligohet qe menjeher tui telefonoj juve nese femija i juaj mungon paarsy. Ju tregoheni te gatshem qe mungesen e femijes suaj menjeher ta paraqitni, dhe ta lini nje numer te telefonit ne shkolle nen te cilin ne munde tui arrijme ne cdo kohe.

## **Ekipet ndihmese**

Nese ne raste te vecanta konstatojme se edhe me ndihmen e prinderve dhe edukatoreve problemi mungeses ne mesim dhe ikja nga mesimi nuk munde te zgjidhet, ateher deshirojme qe ta leme te hapur mundesine, per inkuadrimin e eksperteve . Kuptohet, me pajtimin e prinderve dhe edukatoreve. Pos arsimtareve, keta eksperte munden me qene bashkepunetor te enteve per te rinj dhe femije, ose psikologe te shkolles, mjeke te shkolles ose persona tjere te kualifikuar per kete problematik.

## **Bashkeveprimi i policise**

Sikur edhe gjer me tani, ne kuader te ketij projekti policia do te vendos kontakt me nxeneset dhe nxenesat te cilet nuk gjinden ne shkolle paradite. Ata do tui drejtohen atyre ne vendtakimet, si shtepite e mallrave, stacionet e trenit, vendet ku luhet dhe menjher do ta lajmerojne shkollen. Veprimtaria e policise ka karakter preventiv dhe nuk don te thote qe nxeneset dhe nxenesat me dhune do te dergohen ne shkolle.